

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me sekretaren juridike Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditëses E.M.nga fshati D., Komuna e K., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, përfaqësuar nga V.K. bashkëpunëtore profesionale, me bazë juridike, anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse, me datën 15 gusht 2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.M.nga fshati D., Komuna e K..
- II. ANULOHET** vendimi i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShC) në Prishtinë, Nr. A 02/442/2015 i datës 09.11.2015 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Paditësja me padinë e datës 4 dhjetor 2015 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit të paditurës Nr. A 02/442/2015 të datës 09.11.2015, me të cilin i është refuzuar ankesa si e pabazuar dhe ka mbetur në fuqi vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së K.. E njëjta pretendon se me vendimin kontestues nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe se nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike dhe se është shkelur Ligji për Shërbyesit Civil me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për pozitën “D. i Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor”. Shton se kandidatja e përzgjedhur N.K. nuk i ka plotësuar kriteret siç parashihet me Ligjin për Edukimin Parashkollor sepse e njëjta nuk ka kualifikimin adekuat dhe përvojën e kërkuar, përderisa paditësja i ka plotësuar të gjitha kushtet duke marr parasysh edhe përvojën 25 vjeçare në institucionet parashkollore. I propozon gjykatës që të aprovojë padinë si të bazuar, të anulojë vendimin e të paditurës si të pabazuar si dhe të vendosë që paditësja të kthehet në punë në pozitën e D. të QEAP “A.” në K. me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe kompensimin e të gjitha pagave që nga momenti i ndërprerjes së punës, deri në kthimin definitiv, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e tjera gjyqësore.

E autorizuar e të paditurit në përgjigje në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kundërshtuar padinë e paditëses dhe ka kërkuar nga gjykata që të refuzojë të njëjtën si të pabazuar me pretendimin se procedura e rekrutimit deri në zgjedhjen përfundimtare është bërë në pajtim me nenin 11 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe se kandidatja e përzgjedhur N.K., i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas Udhëzimit Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së D. dhe Z. të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues. Po ashtu thekson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e K. ka nxjerrë vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj në rastin e ankesës së ankueses E.M.sepse e njëjta nuk ka ofruar dokumentet përkatëse për të përmbushur kriteret për dosjen penale dhe planin zhvillimor, në pajtim me Udhëzimin e lartcekur. I propozon gjykatës që të refuzojë padinë e paditëses si të pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës, si vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15 gusht 2018, ka bërë administrimin e provave dhe atë: diploma në emër të paditëses nga fakulteti Filozofik nr....e dt. ..., konkursi i datës 02.07.2015, vendimi kontestues A 02-442/2015 i datës 09.11.2015, vendimi nga Komuna e K. nr.16-24524 i datës 31.08.2015, lexohet vendimi nr.2/602 i datës 04.05.2015, kërkesa për punësim e datës 13.07.2015, vërtetimi nga PARK Qendra Gj., certifikata nr.1138 e datës 12.05.1985, licenca e mësimdhënësit nr.... me datë të lëshimit ..., certifikatat e trajnimeve në emër të paditëses, vërtetimi mbi marrëdhënien e punës nr,... i datës ..., certifikata shëndetësore e datës ..., certifikata nga Gjykata Themelore Ferizaj-dega Kaqanik nr.2778/14 e datës 03.12.2014, lexohet certifikata P.nr.1234/2013 e datës 31.07.2014, lexohet njoftimi për anulimin e konkursit nr.111-11526/2015 i datës 29.05.2015, vendime për emërimin e d. të shkollës fillore të datës 22.10.1999 dhe 15.08.1995, rekomandimi i të paditurës i datës 1302.2013, Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës MLC.nr.2/2012 të datës 03.06.2013, Plani zhvillimor i QEAP "A." për vitin 2015-2019, ankesa e paditëses e datës 10.09.2015, lexohet vendimi për refuzimin e ankesës nr.16-24524 i datës 31.08.2015 si dhe propozimi për përmbardim i datës 02.06.2014, Aktgjykimi AA.nr.95/2017 i datës 14.06.2017, Aktgjykimi A.nr.1727/2014 i datës 11.01.2017, përgjigja në ankesë nga zyra e personelit e Komunës së K.nr.1630959/15 e datës 30.09.2015, detajet e përshkrimit të punës, kërkesa për fillimin e rekrutimit e datës 12.06.2015, vendimi për formimin e komisionit përzgjedhës nr.111-8880/2015 i datës 20.07.2015, formulari "A" dhe "B" të dt. 28.07.2015 dhe 20.07.2015, procesverbali nga DAK e Komunës së K. nr.118-3322/2015 i datës 30.04.2015, formulari "H" i datës 28.07.2015, formulari "E" i dt. 28.07.2015, njoftimi nr.111-18880/2015 i datës 29.07.2015, protokollet e intervistimit të datës 28.07.2015, formulari "D" i datës 28.07.2015, formulari "C" i datës 28.07.2015, vendimi për formimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave nr.16-23273/2013 i datës 04.08.2015,

ankesa e paditëses e datës 03.08.2015, vendimi i të paditurës A/02/812/2015 i datës 24.04.2015, certifikata nga Gjykata Themelore në Ferizaj PNDR.nr.666/15 i datës 14.05.2015, licenca e mësimdhënës në emër të kandidates N.R. nr.... e datës ..., vërtetimi për përfundimin e trajnimit për N.K.n e datës 9 Korrik 2015, diploma e kualifikimit universitar nga UP Prishtinë e datës 21.11.2011, vërtetimi nga SHPMU “D.” NR.... e datës ..., në emër të N.K.t, certifikata shëndetësore në emër të N.K.t e datës 15.05.2015, vendimi nga DAK Komuna K. nr.113-20238/2015 i datës 25.06.2015, aktvendimi nga Gjykata Themelore në Ferizaj GJ.A.nr.227/18 i datës 11.06.2018, E-maili i datës ... nga I.K., shkresat përcjellëse nga Sekretari i Përgjithshëm MASHT nr.111-1307 i datës 18.09.2015, përgjigja nga Sekretari i Përhershëm i MASHT nr.212-958-3 e datës 28.02.2017, vendimi nr.2/602 i datës 04.05.2015, njoftimi nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit KMLC nr.86/2016 i datës 11.01.2017, urdhri nga e paditura i datës 23.02.2010, certifikata në emër të paditëses e lëshuar nga KEDP e vitit 2004, kërkesa e paditëses drejtuar në MASHT nr.958-2 e datës 25.07.2017, kërkesa e paditëses drejtuar Komunës së K. e datës 26.07.2017, kërkesa e paditëses për Kuvendin e Komunës së K.e datës 18.03.2016, kërkesa për Gjykatën Themelore në Ferizaj e datës 06.09.2017 si dhe pasqyra bankare nga R.B. në emër të paditëses për periudhën prej 01.01.2009 deri më 12.10.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Me vendimin Nr.A 02/442/2015 të datës 09.11.2015, e paditura KPMSHC ka refuzuar ankesën e paditëses dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së K. Nr.16-24524 të datës 31.08.2015.

Paditësja e pakënaqur me këtë vendim, ka konstestuar ligjshmërinë e të njejtit dhe me padi i është drejtuar kësaj gjykate duke kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet.

Për të vlerësuar kërkesëpadinë e paditëses si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata fillimisht iu referua Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 11 paragrafit 1 i cili përcakton se:

“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkuirsit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”.

Ndërsa me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ i MASHT Nr. 08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së D. dhe të Z. të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, përcaktohen kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs ku paragrafi 4 i këtij neni përcakton dokumentet që kandidatët duhet të posedojnë :

“4.1. Certifikatën e lindjes;

4.2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;

4.3. Dëshminë për përvojën e punës;

4.4. Portofolion profesionale (shih shtojcën G)

4.5. Letërreferencë nga një institucion publik-kredibil (si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i Shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë);

4.6. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;

4.7. Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, Arial) sipas udhëzimeve të MASHT;

4.8. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;

4.9. Dëshminë se nuk është nën hetime”.

Në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga e paditura në gjykatë, nga dosja e kandidates N.K. e pranuar në pozitën për “D. i Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor” vërehet se e njëjta nuk posedon planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor siç kërkohet me udhëzimin e lartcekur.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat, ka vërejtur se komisioni përzgjedhës në formularët e vlerësimit disa herë i është referuar planit zhvillimor të kandidates N.K. me ç'rast edhe ka bërë vlerësim të veçantë në formularin “D”, mirëpo që i njëjti nuk është dorëzuar në gjykatë, pavarësisht se e paditura ka qenë e obliguar t'i dorëzojë të gjitha provat me përgjigje me padi.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktitke, e ka obliguar përsëri të paditurën që të dorëzojë dosjen e kandidates N.K. dhe se e njëjta kishte dorëzuar dosjen brenda afatit të caktuar kohor, mirëpo që në dosje mungon plani zhvillimor të cilit i referohet komisioni përzgjedhës.

Andaj për gjykatën nuk është e qartë nëse ky plan ka ekzistuar me rastin e vlerësimit apo bëhet fjalë për ndonjë plan fiktiv.

Neni 10 i Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcakton funksionet e Këshillit si në vijim:

" 1. Këshilli ka këto funksione:

1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;

1.2. vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;

1.3. mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil".

Meqenëse posedimi i planit zhvillimor për kandidatët që konkurrojnë për pozitat e drejtorit dhe zëvendës drejtorit në institucione edukativo-arsimore është kriter i përcaktuar me udhëzimin administrativ, atëherë gjykata vlerëson se në këtë procedurë nuk janë zbatuar rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil, për të cilën është dashur të kujdeset e paditura sipas dispozitave të lartcekura.

Lidhur me këtë, gjykata i vlerëson të bazuara pretendimet e paditëses se kandidatja e përzgjedhur nuk i plotëson kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, pretendime të cilat është dashur t'i ketë parasysh e paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues.

Ndërsa i vlerëson irrelevante pretendimet si në kërkesëpadi për kthim në vendin e punës dhe kompensim të të ardhurave, pasi që vendimi i atakuar ka të bëjë vetëm me procedurën e rekrutimit e i cili vendim konsiderohet me të meta thelbësore, për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij nga ana e gjykatës para se këtë ta bëjë organi i paditur sipas vërejtjeve të gjykatës.

Andaj, lidhur me këtë gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i menjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 2064/15, më datë 15 gusht 2018

Sekretarja Juridike

Nazmije Beka

G j y q t a r j a

Arjeta Sadiku

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.